

VENDIM
Nr.416, datë 11.7.2007

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË
BASHKISË ELBASAN TË QARKUT TË ELBASANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Elbasan të qarkut të Elbasanit, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 166 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 947 (nëntëqind e dyzet e shtatë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia e Elbasanit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Elbasan

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
5, 118, 451-452, 844-853	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
21-23, 26	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve administrative	Në pronësi
28, 29	Prona që përdoren nga partitë politike	Në pronësi
51-112	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
405-407, 409-420	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
238-247, 265, 266, 267, 268, 269, 456, 842, 843	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
248-259, 263, 264, 271	Monumente historike e kulturore dhe buste me interes vendor	Në pronësi
272, 841	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve sociale	Në pronësi
280-399, 854-947	Prona që përdoren për strehim dhe mbrojtjen civile	Në pronësi
400-402, 490-617, 641-656	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte) dhe shërbime publike	Në pronësi

486	Varreza publike	Në pronësi
618-640	Troje dhe hapësira	Në përdorim